



UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
SENATI AKADEMIK

Nr. 1051 prot.

Elbasan, më 11.05.2021

VENDIM

Nr. 12 datë 11.05.2021

**"PËR SHPALLJEN E PROCESIT TË REGJISTRIMIT TË KANDIDATURËS
PËR ANËTAR PËRFAQËSUES TË STUDENTËVE NË KOMISIONIN
INSTITUCIONAL ZGJEDHOR TË UNIVERSITETIT TË ELBASANIT
"ALEKSANDËR XHUVANI"**

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Statutit të UE-së dhe Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatit Akademik në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", neni 6, Senatit Akademik më datë 11.05.2021,

VENDOSI:

1. Të shpallë procesin e kandidimit për anëtar përfaqësues të studentëve në Komisionin Institucional Zgjedhor të UE-së.
2. Regjistrimi i kandidatëve fillon më datë 11.05.2021 dhe përfundon më datë 14.05.2021, ora 09:00.
3. Kandidatët studentë të interesuar të dorëzojnë pranë sekretarisë së Senatit Akademik kërkesën për vetëkandidim.
4. Ky vendim të publikohet në faqen elektronike zyrtare të UE-së.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


KRYETARI
Prof. Dr. Skender TOPI